



Institucioni : Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këtë pozitë:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Mbështetje Operative

Nr. ref.: RN00005459

Kategoria funksionale: Niveli administrativë

Koeficienti: 6

Lloji i pozitës: I karrierës

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: 1 vit periudha provuese

Vendi i punës: Prishtinë

Mbikëqyrës: Bordi / Drejtori i Departamentit për Administratë

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i mbështetjes administrative dhe teknike për Bordin e ARH-ës

Detyrat Kryesore

- Ndhmon në organizimin e punës dhe menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme të zyrës së Bordit
- Bashkëpunon me udhëheqësit e departamenteve, divizioneve dhe zyrave sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit.
- Përgatit raporte periodike të aktiviteteve të Bordit
- Ofron mbështetje administrative dhe teknike për Bordin Mbikëqyrës
- Pranon / Shpërndan dokumente që i drejtohen bordit
- Azhurnon kopjet elektronike dhe fizike të dokumenteve të ndryshme
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve të bordit
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës.

Shkathtësitë e kërkuara

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, Ekonomik, Administratë Publike ose SHL - 2 vite përvojë pune;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e shërbimeve administrative;
- Shkathtësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar me stafin e nivelit administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese të informacionit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare www.arh-ks.org

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurroni.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.